

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Conte te Juventus, për të dale nga kriza: çfarë dihet për zërat që flasin për shkarkimin e teknikut Spalletti
ADRESA	https://lapsi.al/conte-te-juventus-per-te-dale-nga-kriza-çfare-dihet-per-zerat-qe-flasin-per-shkarkimin-e-teknikut-spalletti-i1093772
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:52:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	31a32173d0c99099224094c67127cae91291d3d804ed72e5b0c2e253c21136f6
TEKSTI	89baebf723089d956e9a93ea1b35afed50b7634f9af458cfac07abbb28712de8
PAMJA	ce2a9e713a8b0309ddbe0a9cb259bf783630c76f53709d23f930d88ed32f33de

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9cc0c34f614a845d51626f256f73d3cec20331e9d65ed73e32dfd01903485881
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	80f8ed3d4c77708449a259db492a6c9a12b9addcf62e639a2bd2cb31edd1709
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9cc0c34f614a845d51626f256f73d3cec20331e9d65ed73e32dfd01903485881>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Conte te Juventus, për të dale nga kriza: çfarë dihet për zërat që flasin për shkarkimin e teknikut Spalletti

Pas humbjes me Sassuolo, Luciano Spalletti përfundoi menjëherë në bankën e të akuzuarve, aq sa tifozët po thërrasin tashmë emrin e Antonio Conte.



LAPSI.AL • 15 SEPTEMBER 2026



Goli i Adzic dhe Juventus në tapet. Fitorja e çmendur 3-2 me të cilën Sassuolo mposhti bardhezinjtë në stadiumin Mapei duket se ka hapur tashmë krizën në shtëpinë e Zonjës së Vjetër. Është folur për një Juve tepër të guximshme në fund, e bindur se mund të fitonte dhe naive në nënvlerësimin e kundërsulmeve të vendasve, aq sa la vetëm Douglas Luiz përpara portierit Vicario. Gjykime të ardhura si pasojë e një rezultati sigurisht negativ për një Juventus që, kurrë si këtë vit, duhet të synojë të përmirësojë pozicionin në renditje të sezonit të kaluar.

Dhe pikërisht për këtë arsye Luciano Spalletti përfundoi menjëherë në bankën e të akuzuarve, aq sa tifozët po thërrasin tashmë emrin e Antonio Conte. Shkarkimi nuk është një rrugë e mundshme, sipas administratorit të deleguar Giovanni Carnevali, i cili në përfundim të ndeshjes në Reggio Emilia kishte shprehur mendimin e tij për këtë çështje: "Ndryshimi i trajnerit nuk është në frymën time, duhet të përqipemi të planifikojmë dhe të ndërtojmë: duhet t'i japim kohë dhe të kemi durim, duke e ditur se do të duhet të kapërdijmë edhe kafshata të hidhura".

Përkthimi është i qartë: ndryshimi sot nuk i shërben aspak së mirës së Juventusit, duhet të preket fundi përpara rilindjes. Është pak a shumë kjo ajo që përcillet nga kampi bardhezi, edhe pse emri i një ish-i si Conte ngacmon nostalgjikët: ata që ende kanë para syve triumfet, fitoret, vendosmërinë, pasionin dhe guximin e trajnerit nga Leçe, i aftë të rilindte Juventusin pas Calciopolit, kur askush para tij nuk kishte mundur ta bënte. Për momentin Conte nuk ka një skuadër dhe vetëm thirrja nga një klub i madh ose një projekt ambicioz mund ta bëjë të përfundojë vitin e tij sabatik.

Conte dhe zgjedhja për të bërë një vit sabatik pas Napolit

Sqimi i teknikut Conte, pas dy sezonëve të Napolit, është pikërisht të qëndrojë në vitin

ide



Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsia

MOTITIRANA

23°C

KËMBIMIEURO

91.69

aktuale

28:58

Dhuna policore/ Protestuesit paralajmërojnë përshkallëzim: Do bllokojmë institucionet

08:10



Shtatori ndez protestat/ Qytetarët rikthehen në shesh, 107 ditë mobilizim kundër qeverisë



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndique Lapsin edhe në



Me interes nga publiku

symnimit teknikut Conte, pas dy sezonëve të Napolit, është pikërisht te qendrojnë një vit në pritje përpara se të veprojë. Sigurisht, hipoteza për t'u rikthyer në mes të sezonit nuk ka qenë kurrë në natyrën e tij: ai preferon gjithmonë një projekt që nis në fillim të sezonit, në mënyrë që të mund të menaxhojë personalisht si përgatitjen fizike, ashtu edhe merkaton. Gjë që nuk do të ndodhte nëse do të merrte drejtimin tani.

Ajo që mund ta bëjë të ndryshojë mendje do të ishte, pra, vetëm thirrja e një klubi elitare evropian, të gatshëm të riformësojë sezonin e tij duke ia besuar skuadrën. Po mendon për këtë Manchester United, zhgënjyes në këto ndeshje të para në Premier League, që mbështetet te njohja e kampionatit anglez nga Conte për shkak të përvojave të tij te Tottenham dhe Chelsea. Por nuk do të jetë e lehtë: ish-trajneri i Juventus dhe Napolit, në fakt, pikërisht me Spurs ka përjetuar përvojën e tij të parë dhe të vetme si trajner i marrë në mes të sezonit dhe sigurisht që nuk shkoi aspak mirë.

Për këtë arsye Juventus, i cili padyshim zë gjithmonë një vend të veçantë në zemrën e tij, mund të përfaqësojë një përjashtim. Conte jeton ende në Torino me familjen e tij dhe jeta e tij është në Piemonte. Të mendosh sot për një telefonatë nga Juventus duket megjithatë e vështirë: klubi bardhezi duket i orientuar të vazhdojë me bindje së bashku me teknikun Spalletti, edhe pse e di se mund të ketë humbje të tjera dhe pengesa të rëndësishme.

Juventus, sa ndryshime ka pasur në pankinë vitet e fundit

Drejtnesit nuk duan të përballen më me ndryshimet e shumta dhe të njëpasnjëshme në pankinë që janë parë në këto vite: nga Sarri te Pirlo, duke kaluar te rikthimi i Max Allegri, Montero (i përkohshëm), Thiago Motta, Tudor, Brambilla (i përkohshëm) dhe në fund Spalletti. Shumë për traditën e bardhezinjve, që historikisht dhe nën drejtimin e familjes Agnelli, kanë pasur shpesh prirjen për të shkarkuar pak trajnerë, duke preferuar një rrugëtim afatgjatë me një trajner-menaxher në stilin anglez (siç ka ndodhur, për shembull, me ciklet e ngritura nga Trapattoni, Lippi dhe vetë Conte e Allegri).

Fjala kyçe duhet të jetë vazhdimësia, edhe sepse kurrë si sot financat e klubit nuk lejojnë shumë përmbyesje: shkarkimi i teknikut Spalletti do të nënkuptonte mbajtjen në bilanc të një kontrate të rëndë si për kohëzgjatjen, ashtu edhe për pagën, ndërsa angazhimi i Contes do të kërkonte një përpjekje të ngjashme. Me pak fjalë, Juventus për momentin preferon të ruajë qetësinë dhe të vazhdojë me projektin Spalletti.

Trajneri, përpara se ta kthente Napolin në një projekt të përsosur me fitimin bindës të titullit në vitin 2023, kishte arritur me kampanët vetëm vendin e tretë në sezonin paraardhës (rezultat që gjithsesi i kishte rikthyer napolitanët në Champions pas dy vitesh). Për këtë arsye drejtnesit bardhezi duan t'i japin trajnerit kohë të mjaftueshme përpara se të nxjerrin përfundime, pa u përfshirë nga nxitimi apo pa u kushtëzuar nga frustrimi legjitim i tifozëve të tyre.

Të këshilluara



City shënon, Ruben Dias vrapon të festojë, por kthehet menjëherë: iu kujtua rregulli i vendosur

Ruben Dias u nis si të gjithë shokët e tij të skuadrës për të shkruar të festonte autorin e golit në sektorin e tifozëve miq në Old Trafford, por papritur ktheu drejtimin,



"Duhet të kesh turp", Kolarov shpërthen ndaj arbitrit Pairetto: zv/trajneri i Inter përjashtohet direkt

Nervat shpërthyen dhe çuan në përjashtimin e zëvendësit të Chivu, Aleksandr Kolarov, i cili nuk u përmbajt duke protestuar hapur ndaj arbitrit Pairetto, që nuk mendoj dy herë për t'i treguar kartonin e kuq.



Rama lëshon Ballukun/ Top Channel nis sulmin: "Pse SPAK vonon kërkesën për arrestimin"



PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane



Del një tjetër PERGJIM i Ron Yeffet: Ministrinë e Energjetikës ma lini mua



Abazi-Ademi, fijet bashkohen te Balluku/ A po del në dritë skema për marrjen e Aeroportit të Vlorës?



“Ju nuk e njihni”: Kaiki mahnit me Parmën, Fabregas i bën elozhe. Kush është talenti i ri i Comos



Gasperini parashikues, i thonë në konferencë se Interi po humbet 0-2: përgjigjet “Sa është ora?”

Gjatë konferencës për shtyp të teknikut Gian Piero Gasperini, dikush e informon trajnerin për atë që po ndodh disa qindra kilometra më tej: Interi po humbet 0-2 kundër Udineses.



Portieri kërcënohet me vdekje para ndeshjes: “Duhet të pësosh të paktën 3 gola”. Zëvendësohet pas 3-0

Tre gola. Ishte shifra e përfshirë në kërcënimin që Manuel Ferrel, portieri i Guabirã, dyshohet se kishte marrë pak para se të zbriste në fushë kundër Always Ready në kampionatin bolivian.



Gafë tjetër e portierit, por Inter është i frikshëm: nën dy gola dërrmon Udinesen 5-3, Roma e Como e ndjekin

Inter e nis në mënyrën më të keqe të mundshme ndeshjen ndaj Udineses, por më pas zgjohet dhe fiton 5-3: kështu barazon Romën në kuotën e 12 pikëve, ndërsa Chivu dhe Gasp janë në krye me pikë të barabarta



Jo më me Brazilin është një vendim i Neymar, Ancelotti: “Nuk dëshiron të rikthehet në kombëtare”



“Adria nuk donte t'i shënjente kurrë”: teoris



Adzic nuk donte t'i shënohte Juventus, t'lehtë e komplotit evidenton hezitimin e lojtarit të huazuar te Sassuolo

Goli i fitores së skuadrës së teknikut Aquilani u shënua nga Vasilije Adzic, i cili është ende në pronësi të klubit bardhezi dhe muajin e kaluar u huazua te skuadra jeshilzi kundrejt pagesës prej 500 mijë eurosh.



Tifozët kërkojnë Antonio Conte në pankinë, Carnevali: "Nuk kemi ndërmend të largojmë Spallettin"


Pas katër javësh kampionat, Juventus është tashmë shumë larg kreut të renditjes së Serie A dhe pankina e teknikut Luciano Spalletti nuk duket më aq e sigurt.



Maran rrëfëhet në intervistën e pazakontë, nga tava e dheut te gjuha shqipe: "Avash-avash"

Rolando Maran rrëfen muajt e parë në Shqipëri dhe zbulon një anë më personale, larg presionit të rezultateve dhe ndeshjeve të Kombëtares.

Me sytë katër



28:36

PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane

Një denoncim është publikuar së fundmi nga një qytetar shqiptar, i cili ndodhej në avionin me të cilin Edi Rama ka mbër...




Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

11:43



PAMJET/ Shoferi ishte pa ndjenja, polici jashtë detyrës ndalon makinën

11:17



A po eksporton apo jo armë Shqipëria? Ministria e Mbrojtjes me dy versione (VIDEO)

16:47



"Plaka ime s'di pultin e TV dhe jo më e-Albania"/ Korreshi tallet në Komisionin e Ligjeve

21:56

SPORT

→ Të tjerë artikuj



19:50

Conte te Juventus, për të dale nga kriza: çfarë dihet për zërat që flasin për shkarkimin e teknikut Spalletti



15:12

City shënon, Ruben Dias vrapon të festojë, por kthehet menjëherë: iu kujtua rregulli i vendosur



14:12

"Duhet të kesh turp", Kolarov shpërthen ndaj arbitrit Pairetto: zv/trajneri i Inter përjashtohet direkt



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.